



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Adresa: Rr. "Abdi Toptani", ish-hotel "Drini", Tiranë

Tel 04 22268141; 22268142

Nr. 1534/3 Prot.

Tiranë, më 09.11.2017

V E N D I M

Nr.227, datë 09/11/2017

"Mbi përfundimin e procesit të verifikimit të zbatimit të Vendimit të Komisionerit Nr. 71, datë 06.04.2017, "Mbi përfundimin e procesit të verifikimeve të paligjshme të emërimit filluar me vendimin Nr. 30, datë 10.02.2017", në Bashkinë Kavajë"

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, dhe Rregulloren, "Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit", miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të relacionit dhe mendimit paraprak të Drejtorisë së Çështjeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë, në lidhje me verifikimin e zbatimit të Vendimit të Komisionerit Nr. 71, datë 06.04.2017, "Mbi përfundimin e procesit të verifikimeve të paligjshme të emërimit filluar me vendimin Nr. 30, datë 10.02.2017", në Bashkinë Kavajë,

VËREJ SE:

Me Vendimin Nr. 30, datë 10.02.2017, "Për verifikimin e zbatimit të vendimit të Komisionerit Nr. 74, datë 29.06.2016, dhe ligjshmërinë e veprimeve administrative të kryera nga Bashkia Kavajë, gjatë procesit të emërimeve, të kryera prej datës 01.01.2016 e në vazhdim", Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil ka vendosur kryerjen e procesit të kontrollit të akteve të emërimit, të cilat janë marrë në kundërshtim me kërkesat ligjore për respektimin e procedurave të rekrutimit në shërbimin civil, për periudhën nga data 01.01.2016 (momenti i përfundimit të mbikëqyrjes së realizuar më parë në këtë institucion) e në vazhdim. Ky proces është përmbyllur me Vendimin Nr. 71, datë 06.04.2017, në të cilin është vendosur:

"1. Të kërkoj nga Kryetari i Bashkisë Kavajë që për rregullimin e ligjshmërisë, të anulojë aktet e emërimit që kanë dalë në kundërshtim me ligjin, për 4 (katër) punonjësit e mëposhtëm:

- ✓ ***Të anulojë aktin nr. 06 prot., datë 01.02.2016, për emërimin e punonjësit ***** , me pozicion "Përgjegjës në Sektorin e Ndihmës Ekonomike, në Drejtorinë e Shërbimit Social";***

- ✓ Të anulojë aktin nr. 85 prot., datë 30.05.2016, për emërimin e punonjësit *****, me pozicion “Drejtor në Drejtorinë e Shërbimeve Publike”;
- ✓ Të anulojë aktin nr. 86 prot., datë 30.05.2016, për emërimin e punonjësit *****, me pozicion “Specialist në Drejtorinë e Kulturës, Turizmit, Trashëgimisë Kulturore dhe Sporteve”;
- ✓ Të anulojë aktin nr. 189 prot., datë 13.11.2016, për emërimin e punonjësit *****, me pozicion “Specialist në Drejtorinë e Kontrollit, Zhvillimit Urbanistik dhe Pronave”.

2. Njësia përgjegjëse, të planifikojë veprimtarinë, me qëllim që anulimi i akteve të emërimit prej Kryetarit të Bashkisë, të kryhet në mënyrë të alternuar me procesin e shpalljes së pozicioneve të lira dhe fillimin e procedurës së konkurrimit, sipas neneve 22, 23, e vijues, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, duke e ndarë në dy faza.

3. Njësia përgjegjëse të hartojë për vitin 2017 planin e punës së pranimeve në shërbim civil, për zhvillimin e procedurave të konkurrimit, për pozicionet që do të mbeten të lira, zbatimi i të cilit do të ndiqet nga Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, duke mbajtur parasysh orientimet, në pikat më sipër të këtij vendimi.

4. Pozicionet në fjalë duhen të plotësohen me anën e procedurave të konkurrimit të hapur, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, dhe akteve nënligjore dalë për zbatim të tij, apo nëpërmjet procedurave të lëvizjes paralele dhe të ngritjes në detyrë.

5. Njësia përgjegjëse gjatë zhvillimit të procedurave të konkurrimit, duhet të kujdeset që të përmbushë rregullat e përcaktuara në Kreun IV “Pranimi në shërbim civil”, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, Vendimin Nr. 242, datë 18.03.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese” dhe Vendimin nr. 243, datë 18.03.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”, si dhe Udhëzimin nr. 2, datë 27.03.2015, “Për procesin e plotësimit të vendeve të lira në shërbimin civil nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë për kategorinë e mesme dhe të ulët drejtuese dhe pranimin në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive nëpërmjet konkurrimit të hapur”, të Departamentit të Administratës Publike.

6. Njësia përgjegjëse e Bashkisë Kavajë të fillojë zbatimin e vendimit brenda **30 ditëve** nga data e marrjes dijeni dhe pas këtij afati të dërgojë pranë Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, një informacion të detajuar bashkë me planin e masave organizative, që materializojnë veprimet administrative që do të kryhen, për zbatimin e këtij vendimi.”

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, me qëllim verifikimin e zbatimit të detyrave të lëna në Vendimin Nr. 71, datë 06.04.2017, “Mbi përfundimin e procesit të verifikimeve të paligjshme të emërimit filluar me vendimin Nr. 30, datë 10.02.2017”, në Bashkinë Kavajë, të Komisionerit, me Vendimin Nr. 179, datë 27.07.2017, “Për verifikimin e zbatimit të vendimit të Komisionerit Nr. 71, datë 06.04.2017, ‘Mbi përfundimin e procesit të verifikimit të akteve të paligjshme të emërimit, filluar me Vendimin Nr. 30, datë 10.02.2017’, ka vendosur fillimin e verifikimit të zbatimit të këtij vendimi.

Për këtë qëllim u ngrit grupi i punës, i cili në datën 11.09.2017, u paraqit pranë institucionit të Bashkisë Kavajë.

Verifikimi u realizua nëpërmjet vizitës në institucionin e Bashkisë Kavajë dhe subjekti u njoftua për fillimin e procesit me shkresën nr. 1534/2 prot., datë 27.07.2017, “Njoftim për fillimin e verifikimit”.

Grupi i punës, gjatë vizitës në subjekt komunikoi me njësinë e menaxhimit të burimeve njerëzore dhe verifikoi materialet shkresore të cilat vërtetohin zbatimin e detyrave të lëna nga Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil në vendimin paralajmërues. Takimi me njësinë e burimeve njerëzore, si dhe verifikimi i akteve dhe dokumentacionit shoqërues që administrohej nga kjo zyrë dhe zyra e Arkiv-Protokollit, është materializuar në procesverbalin e datës 11.09.2017, të mbajtur nga grupi i punës i Komisionerit dhe personat e kontaktit të institucionit, në Bashkinë Kavajë.

Pasi u administruan dhe u trajtuan materialet shkresore, të vëna në dispozicion, rezultoi se:

- Në pikën 1 të Vendimit të Komisionerit i është kërkuar Kryetarit të Bashkisë Kavajë, që për rregullimin e ligjshmërisë të anulojë aktet e emërimit që kanë dalë në kundërshtim me ligjin, për **4** (katër) punonjës. Në zbatim të këtij vendimi, njësia përgjegjëse e institucionit, Bashkia Kavajë, ka anuluar aktet administrative si më poshtë:
 - ✓ Me aktin Nr. 67, datë 10.05.2017, është anuluar akti administrativ Nr. 06, datë 01.02.2016, për emërimin e punonjësit ***** , në pozicionin “Përgjegjës në Sektorin e Ndhmës Ekonomike, në Drejtorinë e Shërbimit Social”;
 - ✓ Me aktin Nr. 63, datë 09.05.2017, është anuluar akti administrativ Nr. 85, datë 30.05.2016, për emërimin e punonjësit ***** , në pozicionin “Drejtor në Drejtorinë e Shërbimeve Publike”;
 - ✓ Me aktin Nr. 64/1, datë 09.05.2017, është anuluar akti administrativ Nr. 86, datë 30.05.2016, për emërimin e punonjësit ***** , në pozicionin “Specialist në Drejtorinë e Kulturës, Turizmit, Trashëgimisë Kulturore dhe Sporteve”. Me aktin Nr. 64, datë 09.05.2017, “Për lirim nga detyra”, këtij punonjësi i është bërë ndërprerja e marrëdhënies në shërbimin civil në pozicionin e sipërcituar.
 - ✓ Me aktin Nr. 66, datë 10.05.2017, është anuluar akti administrativ Nr. 189, datë 13.11.2016, për emërimin e punonjësit ***** , në pozicionin “Specialist në Drejtorinë e Kontrollit, Zhvillimit Urbanistik dhe Pronave”.

Gjatë verifikimit në subjekt rezultoi se punonjësit: ***** , ***** dhe ***** , janë transferuar në Agjencinë e Shërbimeve Publike pranë Bashkisë Kavajë, pozicione pune që nuk përfshihen në shërbimin civil.

- Komisioneri në pikën 2 të vendimit ka rekomanduar njësinë përgjegjëse që anulimin e akteve të emërimit dhe procesin e shpalljes së pozicioneve të lira ta bëjë në mënyrë të alternuar dhe ta ndajë në dy faza. Në këtë rast njësia përgjegjëse ka filluar dhe përfunduar procedurën e konkurrimit të hapur vetëm për pozicionin “Përgjegjës në Sektorin e Ndhmës Ekonomike, në Drejtorinë e Shërbimit Social”, ndërsa pozicionet “Drejtor në Drejtorinë e Shërbimeve Publike” dhe “Specialist në Drejtorinë e Kulturës, Turizmit, Trashëgimisë Kulturore dhe Sporteve” janë shpallur të lira dhe procedura nuk ka përfunduar ende. Pozicioni “Specialist në Drejtorinë e Kontrollit, Zhvillimit Urbanistik dhe Pronave” nuk ekziston më në strukturën aktuale të Bashkisë Kavajë.

- Njësia përgjegjëse e Bashkisë Kavajë, në përputhje me nenin 18 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 108, datë 26.02.2014, “Për planin vjetor të pranimi në shërbimin civil” dhe në zbatim të orientimeve në pikën 3 të vendimit të Komisionerit, ka hartuar planin e punës së pranimeve në shërbimin civil me Urdhrin Nr. 14/1, datë 28.02.2017, “Për miratimin e planit vjetor në shërbimin civil në Bashkinë Kavajë për Vitin 2017”.
- Në pikat 4 dhe 5 të vendimit të Komisionerit i është kërkuar njësisë përgjegjëse, që pozicionet e plotësuara në kundërshtim me ligjin të shpallen të lira dhe të plotësohen në përputhje me rregullat e përcaktuara në Kreun IV “Pranimi në shërbim civil”, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; Vendimin Nr. 242, datë 18.03.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese” dhe Vendimin Nr. 243, datë 18.03.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”.

Nga verifikimi në subjekt rezultoi se:

- ✓ Me shkresën nr. 1163 prot., datë 19.04.2017, “Kërkesë për publikim të vendit vakant”, është bërë publike në faqen zyrtare të Shërbimit Kombëtar të Punësimit, akti i shpalljes për plotësim të pozicionit të lirë në shërbimin civil, për pozicionin “Përgjegjës në Sektorin e Ndihmës Ekonomike, në Drejtorinë e Shërbimit Social”.
- ✓ Me shkresën nr. 1293 prot., datë 02.05.2017, “Kërkesë për publikim”, njësia përgjegjëse në përfundim të procedurës së verifikimit paraprak për fazën e lëvizjes paralele ka dërguar për publikim në Shërbimin Kombëtar të Punësimit shpalljen, në të cilën rezulton se nuk ka pasur asnjë kandidat që plotëson kushtet për lëvizje paralele.
- ✓ Me shkresën nr. 1293/1 prot., datë 11.05.2017, “Kërkesë për publikim të listës së kandidatëve”, njësia përgjegjëse ka dërguar për publikim në Shërbimin Kombëtar të Punësimit shpalljen me listën e kandidatëve të cilët plotësojnë kushtet dhe kriteret e veçanta për procedurën e ngritjes në detyrë / pranimi nga jashtë në shërbimin civil, në përputhje me pikën 43 të Kreut III “Ngritja në detyrë”, të Vendimit Nr. 242, datë 18.03.2015, “Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese”, të Këshillit të Ministrave.
- ✓ Me Urdhrin nr. 96, datë 22.05.2017, është ngritur Komiteti i Pranimi për Ngritjen në Detyrë.
- ✓ Me shkresën nr. 1757/1 prot., datë 06.06.2017, njësia përgjegjëse ka dërguar pranë Shërbimit Kombëtar të Punësimit, aktin e shpalljes fitues të kandidatit R. Dranga, i cili rezultoi se ishte vlerësuar me më shumë se 70% të pikëve nga Komisioni përkatës.

Më tej, me shkresën nr. 4190 prot., datë 14.09.2017, “Kërkesë për publikim të vendeve vakante”, drejtuar Shërbimit Kombëtar të Punësimit, është kërkuar publikimi i vendeve të lira si më poshtë:

- “Drejtore në Drejtorinë e Shërbimeve Publike”;
- “Specialist në Drejtorinë e Kulturës, Turizmit, Trashëgimisë Kulturore dhe Sporteve”;

Aktualisht, procedura e plotësimit të këtyre pozicioneve nuk ka përfunduar ende. Për këtë arsye, zbatimi i pikave 2, 4 dhe 5 të këtij vendimi do të jenë objekt i verifikimit të mëtejshëm nga ana e Komisionerit.

Përfundimisht, pas verifikimit të dokumentacionit të administruar arrihet në konkluzionin se njësia përgjegjëse e Bashkisë Kavajë ka bërë përpjekje për të zbatuar me korrektësi Vendimin Nr. 71, datë 06.04.2016, *“Mbi përfundimin e procesit të verifikimit të akteve të paligjshme të emërimit, filluar me Vendimin Nr. 30 datë 10.02.2017”*.

Për këto arsye:

Bazuar në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar; ligjin nr. 44/2015 *“Kodi i procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”* dhe Rregulloren, *“Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”*, miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

VENDOSA:

1. Konstatimin e rregullimit të ligjshmërisë nga ana e njësisë përgjegjëse të institucionit të Bashkisë Kavajë, duke zbatuar plotësisht rekomandimet e pikave 1 dhe 3 të Vendimit Nr. 71, datë 06.04.2017, *“Mbi përfundimin e procesit të verifikimeve të paligjshme të emërimit filluar me vendimin Nr. 30, datë 10.02.2017”*.
2. Verifikimin e mëtejshëm të pikave 2, 4 dhe 5 të vendimit Nr. 71, datë 06.04.2017.
3. Për këtë vendim të njoftohet institucioni i Bashkisë Kavajë dhe të informohet Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, në Kuvendin e Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera STRAKOSHA